



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Tekst zyrtar siç është ndryshuar dhe plotësuar me datë 25.06.2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të nenit 64.2, pika (a) dhe (b); 128.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenit 20, 29.1 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE Nr.11/2009
KODI I MIRËSJELLJES PËR SUBJEKTET POLITIKE, MBËSHTETËSIT E TYRE DHE KANDIDATËT

Neni 1

Qëllimi i Kodit të sjelljes

1.1 Kodi i sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët ka për qëllim krijimin e kushteve në të cilave populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhje të lira, të drejta dhe të mir-informuara, në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Neni 2

Përgjegjësitë e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve

2.1 Këtij Kodi i detyrohen të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre.

2.2 Komisioni i Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) ka autoritet ligjor të marë vendim në pretendimet se janë shkelur dispozitat e këtij Kodi si dhe të shpallë sanksione dhe kompensime në përputhje me proedurat e saj.

2.3 Subjektet politike informojnë në mënyrë të duhur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre rreth dispozitave të këtij Kodi.

2.4 Subjektet politike ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre nga shkelja këtij Kodi.

2.5 Subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre.

2.6 Subjekti politik mund të paraqesë prova pranë KZAP-it që tregojnë se ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar dhe/ose dekurajuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij nga shkelja e Kodi. Këto dëshmi mund të përdoren në përcaktimin e duhur të masave të mëtejshme dhe mund të përfshijë dëshmi se:

- (a) subjekti politik i ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij për dispozitat e këtij Kodi dhe nevojat për të zbatuar dispozitat e tij;
- (b) subjekti politik dhe kandidatët e tij publikisht janë shprehur për dënimin e dhunës, kërcënimeve me dhunë, apo frikësim gjatë procesit zgjedhor;
- (c) subjekti politik në mënyrë publike dhe aktive ka bërë qortimin e anëtarëve, mbështetësve dhe kandidatëve të tij për çdo shkelje të ligjeve të zgjedhjeve;
- (d) subjekti politik nuk ka nxitur, shtytur apo përkrahur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij në shkeljen e Rregullave të zgjedhjeve në ndonjë rast të veçantë apo në raste tjera; dhe
- (e) çdo provë tjetër në lidhje me përpjekjet e subjektit politik për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij nga shkelja e Rregullave të zgjedhjeve.

2.7 Secili kandidat nënshkruan një deklaratë me të cilën konfirmohet se ai ose ajo do i bindet të gjitha ligjeve të aplikueshme dhe mbështet zbatimin e plotë të rezultateve zgjedhore të certifikuar.

Neni 3 Veprimet e ndaluara

3.1 Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga veprimet si në vijim:

- (a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;
- (b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;
- (c) mbajtja ose ekspozimi i armëve të secilit lloj gjatë tubimeve politike ose gjatë çfarëdo lloj ngjarjeje që ka lidhje me aktivitetet e subjekteve politike. Mbajtja e armëve nga personat e tjerë gjatë tubimeve politike/manifestimeve lejohet vetëm në rast se personat që mbajnë armë të tilla janë të autorizuar për një gjë të tillë nga autoritetet përkatëse dhe që Policia e Kosovës është njoftuar paraprakisht se të tilla armë do të mbahen në tubimet e caktuara;
- (d) çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë;
- (e) pengimi ose tentimi për pengimin e gazetarëve për të përmushur detyrat e tyre profesionale;
- (f) premtimi i ndonjë shpërblimi financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve;
- (g) kërcënimi ose tentimi për të kërcënuar subjektet tjera politike, mbështetësit ose kandidatët e tyre;
- (h) nxitja e cilitdo person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote;

- (i) nxitja e personit për të votuar më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje ose të votojë në emër të një personi tjetër;
- (j) abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irituese në KZAP;
- (k) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë; ose
- (l) për qëllime të promovimit të subjektit politik ose kandidatëve të tij duke përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali i cili i referohet personit i cili:
 - (i) është në vuajtje të dënimit të shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë; ose
 - (ii) ka padi të ngritur nga Tribunali dhe i cili nuk i është përmbajtur urdhërit për t'u paraqitur para Tribunalit.

Neni 4

Frikësimi dhe dhuna gjatë procesit zgjedhor

- 4.1 Ndalohet rreptësisht përdorimi apo kërcënimi me përdorim të dhunës i çfarëdo lloji nga subjekti politik, anëtarët, mbështetësit ose kandidatët e tyre.
- 4.2 Asnjë subjekt politik ose kandidatë nuk inkurajojnë, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcënimet me dhunë ose kanosje, gjatë procesit zgjedhor. Secili subjekt politik i informon anëtarët dhe mbështetësit e tij për nevojën për të shmangur një sjellje të tillë.
- 4.3 Fushata zgjedhore organizohet në atë mënyrë që një atmosferë e përshtatshme të mbizotërojë gjatë fushatës zgjedhore.

Neni 5

Veprimet e ndaluara nga shërbyesit publik

- 5.1 Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.
- 5.2 Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik.

Neni 6

Veprimet e ndaluara para procesit të votimit

6.1 Gjatë periudhës njëzet e katër orëshe (24) para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

- (a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda Qendres së Votimithapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit; ose të sigurojnë mbështetjen nga personat që presin për të votuar në vendvotime ose qendra të votimit;
- (b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.
- (c) të shfrytëzojnë megafonët ose sistemet tjera për t'iu drejtuar publikut kudoqoftë në Kosovë me qëllim të ndikimit në votues; dhe
- (d) të shfrytëzojnë mediat lokale ose ndërkombëtare me qëllim të ndikimit në votues.

Neni 7

Pranimi i rezultateve të zgjedhjeve

7.1 Të gjitha subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre obligohen t'u përmbahen rezultateve të zgjedhjeve si dhe të mbështesin zbatimin e plotë të rezultateve zgjedhore të certifikuara.

Neni 8

Sanksionimi për shkeljet e parimeve të këtij Kodi

8.1 Shkelja e nërit nga këto nene të Kodit të Sjelljes, në rastet kur këto shkelje nuk kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, konsiderohet shkelje administrative dhe e dënueshme me gjobë sukurse është përcaktuar nga KZAP-i.

8.2 Shkeljet e Kodit të Sjelljes së përcaktuar nga KZAP-i të cilat kanë tentuar të ndikojnë në rezultat e zgjedhjeve paraqesin vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregull zgjedhore hyn në fuqi më 25.06.2009.

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

